



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRN	
01 Nr./ Br	115/17
Nr. i fq./ Br. st	- 8 -
Data: / Datum	27. 4. 2017
VUSHTRRI - VUCITRN	



KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

Në mbështetje të nenit 1 të Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të kufizuara, Planit Nacional të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2017-2019, nenit 12.2 pika “d” e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41.2, pika “d” e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2017, u aprovua:

PLANI I VEPRIMIT PËR PUNËSIM TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E VUSHTRRI 2017 – 2019

Prill, 2017

Plani Lokal i Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në Vushtrri

Duke parë nevojën për përmirësimin e cilësisë së jetës të personave me aftësi të kufizuara, Komuna e Vushtrrisë dhe Handikosi në Vushtrri kanë punuar në hartimin e Planit lokal të veprimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Ky dokument synon të ndihmojë punësimin e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Vushtrrisë për periudhën trevjeçare 2017-2019. Dokumenti është i bazuar në Strategjinë Nacionale 2013-2023 dhe Planin Nacional të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2017-2019.

Qëllimi kryesor është krijimi i kushteve dhe mundësive të barabarta për Punësimin e PAK në Komunën e Vushtrrisë, si dhe aftësimi dhe riaftësimi profesional për punësimin e personave me aftësi të kufizuar në Vushtrri dhe për secilën objektive janë vendosur aktivitete konkrete dhe afate kohore, si dhe institucioni përgjegjës për të realizuar aktivitetin.

Procesi i hartimit të planit ka qenë gjithëpërfshirës dhe ka pasur një konsultim shumë të gjerë me institucionet lokale, departamentet, drejtoritë kompetente të komunës, si dhe me organizata joqeveritare që punojnë dhe veprojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Janë realizuar punëtori dhe aktivitete të shumta për të marrë mendimet dhe opinionet e organizatave joqeveritare. Procesi i hartimit të këtij plani është përkrahur nga Handikosi në Vushtrri me mbështetje të Komisionit Evropian.

Me këtë plan veprimi Komuna e Vushtrrisë synon të përmirësojë dhe integrojë personat me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat dhe në veçanti duke përfshirë aspektin e punësimit dhe atë social.

Objektivi specifik 1: Krijimi i kushteve dhe mundësive të barabarta për Punësimin e PAK në Komunën e Vushtrrisë

Aktiviteti	Treguesi	Mjetet e verifikimit	Synimi	Institucioni zbatues	Institucioni mbështetës	Afati kohor			Buxheti
						V 1	V 2	V 3	
1.1. Analiza e gjendjes së PAK, numri, kategoritë e aftësisë së kufizuar, kualifikimi, nevojat për aftësim dhe riaftësim, struktura gjinore dhe mosha	<p>Numri i PAK me kualifikim superior/mesëm;</p> <p>Numri i PAK të punësuar në sektorin publik;</p> <p>Numri i PAK të punësuar në sektorin privat;</p> <p>Numri i PAK të vetë-punësuar - vetë-punësimi në baza vullnetare në kuadër të projekteve të ndryshme.</p>	Raporti i publikuar	Pasqyrimi real i gjendjes së PAK në Komunën e Vushtrrisë	OPAK/OJQ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS) / Njësi për të Drejtat e Njeriut	Komuna OPAK OJQ Organizatata ndërkombëtare	x			Shfrytëzimi edhe i resurseve të Njësisë për të Drejtat e Njeriut, resurset e DSHMS, shpenzimet e përfaqëruara për realizimin e këtij aktiviteti do të jenë rreth 6000€

1.2. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në nivel institucional	Komuna merr veprime konkrete për punësimin e PAK në përputhje me ligjin në fuqi	Numri i të punësuarve	Zvoglimi i numrit të PAK të papunësuar në nivel komunal	Komuna me drejtoritë përkatëse, OPAK	Donatorët, OJQ, OPAK, Institucionet tjera publike	x	x	x	Në bazë të koeficientit të zyrtarëve përcaktohet buxheti për këtë aktivitet
1.3. Punësimi i PAK në kompanitë private	Kompanitë private marrin veprime konkrete për punësimin e PAK, së paku të punësohen 12 PAK	Numri i të punësuarve	Zvoglimi i numrit të PAK të papunësuar në nivel komunal	Kompanitë private që operojnë në komunë, OPAK	Zyra e punësimin në Vushtrri, donatorët	x	x	x	Rreth 120.000.00
1.4. Vet-punësimi i PAK përmes granteve komunale / donatorët e jashtëm	Numri i granteve të dhëna nga institucionet komunale së paku 5	Numri i të punësuarve	Rritja e numrit të të punësuarve nga PAK	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, OPAK	Zyra e Kryetarit të komunës, OJQ-të	x	x	x	Rreth 50,000.00

1.5. Aplikimi për grante në Ministritë e Linjës dhe Agjencionet Qeveritare	Numri i granteve të përfituara nga ministritë për punësimin e PAK, së paku 6	Numri i të punësuarve	Rritja e numrit të të vetpunësuarve nga grantet qeveritare	Ministritë e linjës, OPAK	OPAK, OJQ-të	x	x	x	Rreth 80,000.00
1.6. Vet-punësimi i PAK përmes granteve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare	Numri i PAK të punësuar përmes granteve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare, së paku 15	Numri i të punësuarve	Zvogëlimi i numrit të të papunëve nga PAK	Organizatave vendore/ndërkombëtare, OPAK, OJQ, komuna, Zyra e Punësimin	OJQ, komuna, Zyra e Punësimin	x	x	x	Rreth 150,000.00
1.7 Krijimi i këndit informativ për punësim të PAK	Këndi informativ funksional	Numri i informacionit dhe udhëzimeve të shpërndarë	PAK më të informuar dhe udhëzuar në lidhje me punësim të PAK	OPAK dhe OJQ	Donatorët, OJQ, OPAK	x	x	x	3,600.00
1.8. Fushatat vetëdijesuese për punësimin e PAK, në sektorin publik dhe privat dhe për vet-punësim	Numri i fushatave të organizuara	Numri i broshurave, fletëpalosjeve, emitimi i informacionit në	Vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e PAK	OPAK, OJQ-të, Zyra e Punësimin	Komunat, OJQ, OPAK, Donatorë	x	x	x	Rreth 1500.00

		mediat elektronike dhe të shkruara							
1.8.1 Organizimi i sesioneve informuese për kompanitë private	Numri i sesioneve informuese të organizuara (2 x në vit)	Takimet e realizuara	Informimi i kompanive private në lidhje me rëndësinë/përfitimet nga punësimi i PAK	OPAK, OJQ-të	Komuna, OJQ-të	x	x	x	
1.8.2. Organizimi i sesioneve informuese për PAK dhe familjarët e tyre	Numri i takimeve informuese të organizuara me PAK dhe familjar (12 takime për vit – 1 për çdo bashkësi lokale)	Takimet e realizuara	Informimi rreth mundësive për punësim për PAK dhe mbështetja për familjet e tyre	OPAK, OJQ-të	Komuna, OJQ-të	x	x	x	1800€
<i>Objektivi specifike 2: Aftësimi dhe riaftësimi profesional për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në Vushtrri</i>									
Aktiviteti	Treguesi	Mjetet e verifikimit	Synimi	Institucioni zbatues	Institucioni mbështetës	Afati kohor			Buxheti
						V1	V2	V3	

2.1. Identifikimi dhe zgjerimi i profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave të tregut të punës	Numri i profileve të përshtashme për personat me aftësi të kufizuara. Numri i PAK që janë aftësuar nga të gjitha kategoritë e PAK Aftësimi profesional i rreth 36 PAK	Programet e hartuara, profilet e akredituara Listat e PAK që janë certifikuar	Ngritja e kapaciteteve profesionale të PAK	Zyra e punësimit, shkollat profesionale në Vushtri QRAP	Komuna, OPAK, OJQ, bizneset, donatorët	x	x	x	2,000.00
2.2. Informimi dhe orientimi i nxënësve me aftësi të kufizuara të klasave të IX-ta për profilizim profesional në kuadër të “Java e dyerve të hapura” dhe “Dita e vajzave”	Numri i fëmijë me aftësi të kufizuara rreth 90 nxënës	Takimet informuese nëpër shkolla fillore (29 shkolla fillore)	Informimi sa më i plotë i nxënësve rreth mundësive për përzgjedhje të profesioneve	Drejtoria e Arsimit (komuna), Qendra e Orientimit në Karrierë, Qendra e Punësimit, OPAK	OJQ-të, Donatorët	x	x	x	3,000.00
2.3. Ngritja e kapaciteteve të PAK në kompani private (trajtime në punë)	Numri i PAK të aftësuar për profesione të caktuara, rreth 25 PAK	Numri i PAK të involvuar	Ngritja e potencialeve të PAK për punësim në sektorin privat	OPAK, OJQ, bizneset	Zyrat e Punësimit donatorët, komuna, OJQ-të	x	x	x	11,250.00

Për zbatimin e këtij plani obligohet: Shoqata e Fëmijëve dhe të Rriturve me Aftësi të Kufizuar “Handikos” Vushtrri, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Zyra për Barazi Gjinore si dhe Zyra Komunale e Punësimit në Vushtrri.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit